

LIGJ
Nr. 119/2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9363, DATË 24.3.2005, “PËR MËNYRËN DHE PROCEDURAT E VENDOSJES DHE KALIMIT TË FORCAVE USHTARAKE TË HUAJA NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, SI DHE PËR DËRGIMIN E FORCAVE USHTARAKE SHQIPTARE JASHTË VENDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë:

Neni 1

Titulli i ligjit ndryshohet si më poshtë:

“Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë.”.

Neni 2

Në nenin 1, fjalët “parimet e Organizatës së Atlantikut të Veriut” zëvendësohen me fjalët “Traktatin e Atlantikut të Veriut”.

Neni 3

Në nenin 2 bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

a) Në pikën 1, shkronja “ç”, pas fjalës “Pjesëmarrjen”, shtohen fjalët “e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

b) Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në strukturat e Organizatës së Atlantikut të Veriut, të Bashkimit Europian, në organizatat ndërkombëtare dhe shtabet ushtarake ndër-kombëtare.”.

Neni 4

Në nenin 3, në fund të pikës 1 shtohen fjalët “si dhe operacionet e vetëmbrojtjes kolektive, në kuadër të nenit 5, të Traktatit të Atlantikut të Veriut.”.

Neni 5

Neni 4 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 4

Delegimi dhe pranimi i autoritetit të komandimit

1. Autoriteti kompetent, sipas ligjit përkatës për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për qëllime të bashkëpunimit ushtarak ndërkombëtar, mund t’i transferojë pjesë të autoritetit të vet komandantit ushtarak të strukturave të Traktatit të Atlantikut të Veriut, të një shteti të huaj ose një organizate ndërkombëtare. Në të njëjtën mënyrë, autoriteti kompetent shqiptar mund të pranojë një autoritet që i jepet nga një komandant ushtarak i strukturave të Traktatit të Atlantikut të Veriut, i një shteti të huaj ose nga një organizatë ndërkombëtare.

2. Autoriteti kompetent për dërgimin e njësive ushtarake në operacione ushtarake ndërkombëtare, në çdo rast, në aktin e dërgimit duhet të përcaktojë misionin dhe mandatin e këtyre forcave. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, në zbatim të misionit dhe mandatit të përcaktuar, miraton rregullat e angazhimit për këto njësi ushtarake.”.

Neni 6

Në nenin 6, pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Këshilli i Ministrave, me vendim, mundëson lidhjen e një kontrate sigurimi në dobi të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që përmbush qëllimet e përcaktuara në nenin 3, të këtij ligji, e cila garanton pagesën në rast vdekjeje dhe dëmtimi shëndetësor. Kontrata e sigurimit bëhet edhe për personelin e Forcave të Armatosura pjesëmarrës në stërvitje, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 2, si dhe për personelin e strukturave të përcaktuara në nenin 10, të këtij ligji, për kohën që dislokohet në zonë operacioni ushtarak.”.

Neni 7

Pas nenit 9 shtohet neni 9/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 9/1

Dalja e mjeteve të Forcave të Armatosura jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

Mjetet fluturuese, mjetet lundruese, mjetet e transportit dhe të blinduara tokësore, që u përkasin Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, dalin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për qëllimet e këtij ligji, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.”.

Neni 8

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Emërimi i personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në strukturat e Organizatës së Atlantikut të Veriut, të Bashkimit European, në organizatat ndërkombëtare dhe shtabet ushtarake ndërkombëtare

1. Personeli i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë emërohet në strukturat e Organizatës së Atlantikut të Veriut, të Bashkimit European, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.

2. Personeli i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i emëruar në strukturat e Organizatës së Atlantikut të Veriut, të Bashkimit European, në organizatat ndërkombëtare dhe në shtabet ushtarake ndërkombëtare, në përmbushje të kërkesave të pozicionit të punës apo të komandës ku është angazhuar, mund të dislokohet në zonë operacioni ushtarak, për periudha kohore jo më shumë se 30 ditë, me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes.”.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 24.11.2016

Shpallur me dekretin nr. 9884, datë 6.12.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani